



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401408/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda : Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Durrës.

Drejtuar : Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit
Z. Nuri LOCA

Durrës

I nderuar Zoti Loca,

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet".

Në datën 03.11.2014 nga ora 14.30 - 16.30 një grup i përbërë nga Nd/komisionerët e Seksionit të Veçantë Sotiraq Nushi dhe Petrit Azemaj inspektoi Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Durrës dhe Stacionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Portin e Durrësit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të të drejtave të qytetarëve shqiptarë e të huaj që hyjnë e dalin në Portin e Durrësit, të personave të kthyer nga policitë e vendeve të tjera (depërtiv e inad), të kushteve të qëndrimit të tyre, monitorimin e sjelljes së punonjësve të policisë me qytetarët, si dhe verifikimin e zbatimit të Rekomandimit të Avokatit të Popullit për "Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 49, datë 10.01.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të pa paguara në Pikat e Kalimit Kufitar nga shtetasit shqiptarë të cilët udhëtojnë jashtë vendit me automjete".

Grupi i inspektimit mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës nga drejtuesit e këtyre organeve, punonjësit e policisë, disa qytetarë të huaj, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës.

Ambientet e qëndrimit të shtetasve të kthyer nga policitë e vendeve të tjera dhe e shtetasve të huaj që hyjnë me dokumentacion të parregullt:

Në këto organe të policisë kthehen në mënyrë të herë pas hershme nga policitë e vendeve të tjera shtetas shqiptarë numri i të cilëve shkon deri në 6 persona në ditë. Ndërkohë shoqërohen edhe persona të huaj që vijnë në këtë port me dokumentacion të parregullt si dhe shtetas shqiptarë të cilëve u refuzohet dalja jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë.

Për këtë kategori personash në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit Durrës janë përshtatur dy ambiente qëndrimi, njëri është për personat e rritur të gjinisë meshkuj, është me hapësirë të mjaftueshme, me ndriçim të plotë natyral e artificial dhe kushte normale për qëndrimin e qytetarëve ulur në 11 karrige.

Ndërsa ambienti tjetër, i cili përdoret për akomodimin e femrave dhe të familjarëve të rikthyer, është me hapësirë të mjaftueshme, me ndriçim të plotë natyral e artificial dhe kushte normale për qëndrim, i pajisur me një divanë dhe dy kolltukë, si dhe një tualet me kushte normale.

Gjithashtu në këtë drejtori kishte edhe dy dhoma sigurimi nga të cilat njëra e përdorshme, me sipërfaqe rreth 10 m², me ajrim e ndriçim, por nuk kishte orendi (karrige apo stola të fiksuar në dysheme) për qëndrimin ulur të qytetarëve që mbahen aty. Pranë kësaj dhome ishte edhe një tualet me kushte normale.

Ndërsa në Stacionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Portin Durrës kishte dy ambiente me kushte komode ku qëndronin për pak kohë shtetasit shqiptarë të kthyer nga policitë e vendeve të tjera, shtetasit e huaj që hyjnë me dokumentacion të parregullt në vendin tonë, si dhe shtetasit shqiptarë ndaj të cilëve për arsye ligjore vendoset refuzimi për të dalë jashtë shtetit.

Regjistri i personave të shoqëruar:

Personat e rikthyer dhe të shoqëruar në këto organe regjistrohen në sistemin TIMS dhe regjistrin e përkatës, si dhe intervistohen të gjithë nga punonjësit e policisë. Ndërkohë ndaj tyre bëhen edhe verifikime nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Sipas, punonjësve të policisë, koha e qëndrimit në komisariat e këtyre personave shkonte deri në 3- 4 orë.

Nga punonjësit e policisë u informuam se, për komunikimin e tyre me shtetasit e huaj siguroheshin përkthyes dhe kur ishte e nevojshme edhe avokat mbrojtës pa pagesë.

Regjistri i evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar është i modelit të vjetër. Ai nuk është konform kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, pasi në të nuk janë hapur të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar. Në rubrikën “arsyet e shoqërimit” u konstatua se ato ishin për “identifikim” e cila është një arsye e përgjithshme dhe jo e specifikuar për çdo rast konkret. Sipas punonjësve të policisë kjo ndodh për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme në kolonën përkatëse.

Sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët:

Gjatë kohës së inspektimit në këto organe nuk u gjetë asnjë qytetarë i huaj ose vendas i shoqëruar në ambientet e përshkruara më sipër. Gjithashtu në ambientet e

hyrjes dhe daljes së qytetarëve në këtë Pikë të Kalimit Kufitar nuk u gjetën qytetarë sepse oraret e nisjes dhe të mbërritjes së trageteve ishin në mëngjes dhe në darkë.

Ndërkohë gjatë kësaj kohë grupi i inspektimit pati mundësinë e monitorimit të sjelljes së punonjësve të policisë gjatë komunikimit me disa shtetas të huaj, punonjës të ekuipazheve të trageteve që ishin ankoruar në këtë port. Nga monitorimi dhe pyetja e disave prej tyre u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta duke i trajtuar me respekt e dinjitet. Ne gjykojmë se kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë jo vetëm që është një detyrim ligjor, por ndërkohë ajo rrit imazhin dhe prestigjin e organit të Policisë së Shtetit Shqiptar në publik dhe ndaj shtetasve të huaj, si dhe besimin e qytetarëve vendas e të huaj ndaj këtij organi të administratës publike.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e disa karrigeve apo të ndonjë stoli të fiksuar në dysheme në dhonën e sigurisë në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit Durrës.

2. Vendosjen menjëherë të regjistrimit të ri për evidentimit e të dhënave të personave të shoqëruar dhe plotësimin me përgjegjësi të rubrikave të tij duke i dhënë një rëndësi të veçantë njoftimit të familjarëve, të afërmeve apo personit që i shoqëruari beson, orës së njoftimit të tyre, emrit të të njoftuarit dhe numrit të telefonit të tij.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI